

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e Sektorit të veprave civile, të mbajtur më datë 02.12.2019 miratoi si vijon:

## M E N D I M J U R I D I K

I punësuar në sektorin publik (nëpunësi administrativ – punëtor) i sistemuar me aktvendim të punëdhënësit jashtë nga vendi i tij ku banon ka të drejtë për kompensim të shpenzimeve për transport nga dhe deri në vendin e punës në raste kur nuk ka transport të organizuar, por në lartësinë e shpenzimeve më të ulëta reale sipas nenit 21 paragrafi 1 alineja 2 nga Marrëveshja e përgjithshme kolektive e nëpunësve në sektorin publik të Republikës së Maqedonisë.

### A r s y e t i m

Çështja juridike se a ju takojnë të punësuarve në Sektorin publik (nëpunësve administrativ) shpenzime për transport nga dhe deri në punë, në raste kur transporti nuk është organizuar nga ana e punëdhënësit, por nëpunësi administrativ është dërguar për shkak të nevojave të punëdhënësit në vendin e punës jashtë nga vendi i banimit, rrjedh nga iniciativa e parashtruar e një avokati sipas nenit 37 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për gjykatat, duke qenë se ka qëndrime kundërshtuese nga ana e gjykatave gjatë vendimmarrjes dhe sjelljes së vendimeve gjyqësore, ashtu që paraqitet nevoja për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe sigurimin e qëndrimit unik në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave.

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke marrë parasysh nevojën për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe sigurimin e qëndrimit unik në zbatimin e ligjeve, konsideron se sa i përket çështjes juridike të sipërcituar duhet të zbatohen Ligji për nëpunësit administrativ, Ligji për marrëdhëniet e punës si dhe dispozitat e Marrëveshjes së përgjithshme kolektive për sektorin publik të Republikës së Maqedonisë.

Sipas nenit 93 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për nëpunësit administrativ, nëpunësi administrativ ka të drejtë për kompensime të rrogës dhe kompensime tjera në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie të punës, edhe atë për shpenzime rrugore, ditore dhe të tjera për udhëtime zyrtare në vend dhe jashtë vendit, dhe në pajtim me paragrafin 2 nga i njëjti nen lartësia e kompensimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, për çdo vit përcaktohen me Ligjin për realizim të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht me Vendimin për realizim të Buxhetit të Njësisë së vetëqeverisjes lokale. Në paragrafin 3 qëndron se Qeveria e Republikës së Maqedonisë qartë rregullon mënyrën për shpërndarjen e kompensimeve.

Në pajtim me nenin 113 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhëniet e punës, punëtori ka të drejtë kompensimi për shpenzimet lidhur me punën, por në paragrafin 2 nga i njëjti nen është rregulluar se lartësia, baza dhe afati për llogaritjen dhe pagesën e kompensimit të këtyre shpenzimeve përcaktohet me ligj dhe me Marrëveshjen kolektive.

Në pajtim me nenin 21 paragrafi 1 alineja 2 të Marrëveshjes së përgjithshme kolektive për sektorin publik të Republikës së Maqedonisë, punëtori ka të drejtë kompensimi për shpenzimet e transportit nga dhe deri në punë në raste kur nuk ka transport të organizuar në lartësi të shpenzimeve më të ulëta reale.

E drejta e paditësve për kompensim të shpenzimeve për transport nga dhe deri në punë në raste kur nuk ka transport të organizuar në lartësi të shpenzimeve të ulëta reale, është rregulluar me dispozitat ligjore të sipërcituara si dhe me dispozitat nga Marrëveshja e përgjithshme kolektive për sektorin publik të Republikës së Maqedonisë dhe ka të bëjë me të drejtën e cila është më e volitshme për punëtorin – paditësin.

Në rastin konkret, duke qenë se fakti që paditësit kërkojnë shpenzimet e transportit nga dhe deri në punë në raste kur nuk ka transport të organizuar në lartësi të shpenzimeve më të ulëta reale (kartë autobusi), por më e ulët nga shpenzimet më të ulëta nuk mund të konstatohet por as edhe të përcaktohet dhe të përputhet me Aneks marrëveshjen të Marrëveshjes së përgjithshme kolektive për sektorin publik të Republikës së Maqedonisë, që caktohet në nivel vjetor.

**GJYKATA SUPREME E  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT  
SEKTORI I VEPRAVE CIVILE**